



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 37 dt.27.03.1996

Këshilli Bashkiak, i mbledhur me dt.27.03.1996, pasi analizoi relacionet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

VENDOSI

1. Të miratoj çeljen e fondeve në shumën 3.5 milion lekësh për blerjen e një traktori me zinxhirë për Ndërmarrjen e Përpunimit të Plehërave.
2. Të miratoj çeljen e fondeve prej 1 milion lekësh për blerjen e një kioske tip zyra për këtë ndërmarrje.
3. Të miratoj çeljen e fondeve prej 5.5 milion lekësh për blerjen e një makine gërmuese – ngarkuese dherash për Ndërmarrjen e Kuartalleve.
4. Deri në privatizimin e 2 WC publike të kinema Partizanit dhe Kombinati këto 2 WC të kalojnë pranë Ndërmarrjes së Kuartalleve.
5. Të çelet fondi prej 200 mijë lekësh për punëtorët e WC që nuk janë paguar deri tani dhe ky fond i çelur të kalojë në Ndërmarrjen e Kuartalleve për pagesën e tyre.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Administrimit Financiar pranë Bashkisë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA